

VENDIM
Nr.1523, datë 19.11.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.261, DATË 27.2.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE, QË DALIN TË PAPUNË NGA
PROCESI I RISTRUKTURIMIT TË “ARMO” SHA, TIRANË DHE “ALBPETROL”
SHA, PATOS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 5 e vendimit nr.261, datë 27.2.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Shoqëritë do të përballojnë, me likuiditetet e veta, fondet e llogaritura për pagesën e punonjësve, që dalin të papunë, si më poshtë vijon:

a) 478 988 502 (katërqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dy) lekë, për 606 punonjësit, që dalin pa punë nga ristrukturimi i “Armo” sh.a., Tiranë;

b) 672 200 000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy milionë e dyqind mijë) lekë, për 1100 punonjësit, që dalin pa punë, nga ristrukturimi i “Albpetrol” sh.a., Patos”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha